



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 82

Tiranë – E premte, 9 maj 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 257, datë 7.5.2025	Për miratimin e logos dhe të shenjave dalluese të Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve..... 11619
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 258, datë 7.5.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 331, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i linjës 110 kV Lushnjë–Fier’” 11621
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 259, datë 7.5.2025	Për përcaktimin e kushteve dhe të mënyrës për mbrojtjen e veçantë të punonjësit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, të cilit i kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës..... 11623
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 260, datë 7.5.2025	Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik dhe zhvilluesit të zonës me vendndodhje në Xhafzotaj, Shijak..... 11624
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 288, datë 6.5.2025	Për delegim kompetence..... 11627
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 405, datë 25.4.2025	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 21, datë 19.1.2023, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin fundor të qëndrueshëm në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”..... 11627
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 406, datë 25.4.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 11, datë 14.1.2022, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për një shfrytëzim të qëndrueshëm të rezervave të pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18) [rekomandimi i GFCM/44/2021/20]”..... 11627
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 22.4.2025	Çështja Fortuzi kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 29237/18</i>) 11630
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut 24.4.2025	Bukurije Petrela dhe të tjerët kundër Shqipërisë dhe 4 kërkesa të tjera (<i>kërkesa nr. 18948/22</i>) 11632

Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Nazmi Goxhaj.....	11637
Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Muhamet Nure.....	11637



VENDIM
Nr. 257, datë 7.5.2025

**PËR MIRATIMIN E LOGOS DHE TË
SHENJAVE DALLUESE TË
KANCELARISË SË URDHRAVE DHE
MEDALJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 26, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e logos dhe të shenjave dalluese të Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve, sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

ANEKS I

1. Logoja e Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve të Republikës është një gjethe lisi e stilizuar, me ngjyrat kombëtare kuqezi, e cila i brendashkruhet dhe kornizon njëherazi një shqyt, të stilizuar si të papërfunduar, me fushë të zezë dhe bordura të holla të kuqe. Në cepin e djathtë të shqytit (majtas për lexuesin) figuron një yll i praruar me gjashtë cepa me konture të kuqe fine.

Ana e majtë e shqytit përvijohet prej pikës më skajore nga një gjethe e gjelbër dafine. Në të djathtë të logos vendoset akronimi “KUMR”, në ngjyrë të kuqe, dhe poshtë tij, e ndarë me një vizë të zezë horizontale, emri i plotë i institucionit po në të zezë: Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve të Republikës.

Simboli i Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve të Republikës u përgjigjet kriterëve të një logoje, duke përfshirë një paraqitje dhe një lexim pjesërisht heraldik, që e pasurojnë nga pikëpamja strukturore dhe e ndërlidhin me traditën më të mirë të simboleve kombëtare dhe të nderimeve publike në përgjithësi.

Gjethet e lisit dhe të dafinës përfaqësojnë tradicionalisht dinjitetin, lavdinë, guximin dhe trimërinë. Gërshetimi i tyre në formë kurore është një nga simbolet e urdhrave dhe të medaljeve në Evropë e në botë dhe përdoret rëndom si çernierë (kapëse) mes medaljonit të dekoratës e shiritit të saj. Ylli i praruar në cepin e djathtë të shqytit, pra, në pjesën e privilegjuar të tij nga pikëpamja heraldike, përfaqëson yllin gjashtëcepash të vulës së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Ai simbolizon gjithashtu meritën individuale dhe vlerën e posaçme të shërbimit ndaj komunitetit si një shembull ndriçues e frymëzues për kombin.

2. Logoja të jetë sipas modelit të mëposhtëm:



KUMR
KANCELARIA E URDHRAVE
DHE MEDALJEVE TË REPUBLIKËS

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



Shkrimi i akronimit “KUMR” është “*Display Magazine*”, me ngjyrë të kuqe.

Shkrimi “Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve të Republikës” është “*PF DIN TEXT COMP PRO LIGHT*”, me ngjyrë të zezë.

Ngjyrat e logos janë: e kuqe, e zezë, jeshile, jeshile e errët, *tabiti gold* dhe e verdhë, sipas kodeve të mëposhtme:



#BE1E2D



#231F20



#5F8239

#2A3719



#DD8226

#E8CF1B

3. Logoja alternative me ngjyrë bardhezi

Shkrimi i akronimit “KUMR” është “*Display Magazine*”, me ngjyrë të zezë.

Shkrimi “Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve të Republikës” është “*PF DIN TEXT COMP PRO LIGHT*”, me ngjyrë të zezë.

Ngjyra e zezë është sipas kodit “#231F20”.



KUMR

KANCELARIA E URDHRAVE
DHE MEDALJEVE TË REPUBLIKËS

4. Logoja alternative me ngjyrë të kuqe

Shkrimi i akronimit “KUMR” është “*Display Magazine*”, me ngjyrë të bardhë.

Shkrimi “Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve të Republikës” është “*PF DIN TEXT COMP PRO LIGHT*”, me ngjyrë të bardhë.

Ngjyrat e logos alternative me ngjyrë të kuqe janë e kuqe me të bardhë, me sfond të kuq, sipas kodit “#BE1E2D”.



KUMR
KANCELARIA E URDHRAVE
DHE MEDALJEVE TË REPUBLIKËS

VENDIM
Nr. 258, datë 7.5.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 331, DATË 31.5.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT ‘NDËRTIMI I LINJËS 110 kV
LUSHNJË-FIER’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 331, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i linjës 110 kV Lushnjë-Fier’”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën

që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 2 199 890.48 (dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë pikë dyzet e tetë) lekësh.”;

b) Në pikën 4, togfjalëshi “... prej 363 875 (treqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekësh” zëvendësohet me “... prej 2 199 890.48 (dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë pikë dyzet e tetë) lekësh.”.

2. Tabelës, që i bashkëlidhet vendimit nr. 331, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, i shtohet pasuria me numër rendor “68” dhe të dhënat sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë dhe Drejtoria Vendore Fier, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT
“NDËRTIMI I LINJËS 110 kV LUSHNJË–FIER”

Nr. rendor	Nr. shtyllë	Pronari			Të dhëna hipotekore								Vlerësimet për shpronësim							Shënime			Adresa
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Arë			Ndërtesë			Vlera totale (lekë)	Nr. dok .	Data e regjistrimit	Seksionet D & E të kartelës së pasurisë	
													Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)					
		A	B	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V
68	Midis shtyllës 74–75	Veli	Gjysho	Muçaj	Portëz, Fier	3031	285/1	Arë + Truall	6,782		4,014	1,624				180.20		1,836,015.48	1,836,015.48			Konfirmuar nga ASHK-ja.	Fshati: Portëz, NJ. A.: Portëz , Bashkia Fier.
		Islam	Gjysh	Muçaj																			
		Bardhosh	Gjysho	Muçaj																			
		Myserete	Muharem	Muçaj																			
		Floresha	Haxhi	Muçaj																			
		Shqiponja	Myrto	Muçaj																			
SHUMA TOTALE																			1,836,015.48				



VENDIM
Nr. 259, datë 7.5.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE
TË MËNYRËS PËR MBROJTJEN E
VEÇANTË TË PUNONJËSIT TË
AGJENCISË SË MBIKËQYRJES
POLICORE, TË CILIT I KËRCËNOHET
JETA, FAMILJA DHE PRONA PËR
SHKAK TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 75, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (në vijim “AMP”), të cilit, gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij, i kërcënohet jeta, familja dhe prona nga veprime të paligjshme të të tretëve, i sigurohet mbrojtje e veçantë.

2. Me mbrojtje të veçantë kuptohen masat me karakter organizativ e profesional për sigurimin dhe ruajtjen e veçantë të jetës, familjes dhe të pronës së punonjësit të kërcënuar të AMP-së, si dhe çdo masë tjetër, që lidhet me këtë mbrojtje.

3. Punonjësi i kërcënuar i AMP-së përfiton mbrojtje të veçantë nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) prania e rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën e punonjësit të AMP-së;

b) gjendja e punonjësit të AMP-së në një situatë që kërkon kryerjen e veprimeve apo marrjen e masave të menjëhershme për ta zgjidhur atë, si dhe për të shmangur çdo lloj dëmtimi të mundshëm;

c) prania e lidhjes shkakësore ndërmjet rrethanave serioze dhe rrezikut të dëmtimit me ushtrimin e ligjshëm të detyrës.

4. Mënyrat e mbrojtjes së veçantë konsistojnë në:

a) ruajtjen apo shoqërimin fizik të punonjësit të AMP-së të rrezikuar;

b) ruajtjen apo shoqërimin fizik të familjarëve të rrezikuar të punonjësit të AMP-së;

c) ruajtjen e pronës së punonjësit të AMP-së të rrezikuar.

5. Mbrojtja e veçantë për punonjësin e kërcënuar të AMP-së bëhet me vendim të Komisionit për Vlerësimin e Kërcënimeve (KVK), i cili ngrihet dhe

funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

6. Komisioni për Vlerësimin e Kërcënimeve përbëhet nga:

a) zëvendësdrejtori i përgjithshëm, kryetar;

b) drejtori i Hetimit, anëtar;

c) drejtori i Forcës së Posaçme Operacionale, anëtar;

ç) përgjegjësi i sektorit të analizës dhe informacionit, anëtar;

d) drejtori rajonal i qarkut, ku banon personi i kërcënuar, anëtar.

7. Kërkesa me shkrim për mbrojtje të veçantë të punonjësit të kërcënuar të AMP-së i paraqitet Komisionit për Vlerësimin e Kërcënimeve nga:

a) punonjësi i AMP-së, që i kërcënohet jeta, familja dhe prona;

b) struktura të AMP-së, që marrin dijeni për praninë e rrethanave serioze, të cilat i rrezikojnë jetën, familjen dhe pronën e punonjësit të AMP-së;

c) çdo organ tjetër publik, që, për shkak të funksionit, merr dijeni për praninë e rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen dhe pronën e punonjësit të AMP-së.

8. Kërkesa për mbrojtje të veçantë përmban:

a) gjenealogjetet e plota të punonjësit të kërcënuar të AMP-së;

b) një përmbledhje të fakteve e të rrethanave, që përbëjnë rrezik serioz për punonjësin e AMP-së, të cilat e detyrojnë atë të kërkojë mbrojtje të veçantë, si dhe burimin e provave, ku ato bazohen.

9. Komisioni për Vlerësimin e Kërcënimeve, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje të veçantë, vendos:

a) pranimin e kërkesës, duke përcaktuar edhe masat konkrete të mbrojtjes;

b) mospranimin e kërkesës.

10. Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Kërcënimeve miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe përmban:

a) pjesën hyrëse, ku pasqyrohen subjekti që ka bërë kërkesën, koha dhe vendi i marrjes së vendimit, si dhe përbërja emërore e komisionit;

b) pjesën përshkuese, ku jepen rrethanat që e kanë shtyrë subjektin për të bërë kërkesën, veprën penale të kryer, personalitetin e të kërcënuarit, rrezikshmërinë shoqërore të kërcënimeve dhe vlerësimet për të dhënat që zotërohen rreth një fakti të tillë;



c) pjesën vendimmarrëse, ku përcaktohen masat konkrete për mbrojtjen e veçantë, kohën, ekzekutuesin e vendimit, afatin e zgjatjes së masave, shpenzimet dhe subjektin që do t'i përballojë këto shpenzime.

11. Në vendimin e Komisionit për Vlerësimin e Kërcënimeve për sigurimin e mbrojtjes së veçantë përcaktohen mënyrat e mbrojtjes dhe kohëzgjatja e saj.

12. Krahas marrjes së masave mbrojtëse, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore bashkëpunon me institucionet e tjera për marrjen në vazhdimësi të informacioneve, në funksion të parandalimit të ngjarjeve të mundshme kriminale në drejtim të punonjësit të AMP-së të marrë në mbrojtje, familjes dhe pronës së tij.

13. Në rastet kur punonjësi i kërcënuar i AMP-së ushtron detyrën larg vendbanimit dhe familjes së tij, masat urgjente mbrojtëse merren sipas nevojës për të dhe për familjen, në funksion të mbrojtjes e në varësi të intensitetit që ka kërcënimi.

14. Në rastin e një rreziku serioz dhe të çastit, drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore urdhëron strukturat përkatëse në AMP të marrin masa të menjëhershme për të garantuar sigurinë e jetës, familjes dhe pronës së punonjësit të kërcënuar të AMP-së. KVK-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve, vlerëson masat e marra nga strukturat e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe vendos për vazhdimin ose jo të tyre.

15. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 260, datë 7.5.2025

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË
TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK DHE ZHVILLUESIT TË
ZONËS ME VENDNDODHJE NË
XHAFZOTAJ, SHIJAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë Faqe | 11624

dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” të territorit me sipërfaqe 135 215 (njëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) m² dhe sipërfaqe ndërtimore 53 022.3 (pesëdhjetë e tre mijë e njëzet e dy pikë tre) m², pjesë e zonës kadastrale 3852, në Xhafzotaj, Shijak, të përbërë nga parcelat me numrat e pasurive dhe sipërfaqet përkatëse, sipas listës dhe genplanit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shtirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes në “Zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” përcaktohen në genplanin që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Veprimtaritë, që do të zhvillohen në “Zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, janë të llojit:

- a) industri prodhuese;
- b) industri e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit;
- c) industri e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT);
- ç) industri e pajisjeve elektrike dhe elektronike;
- d) industri e produkteve të energjisë;
- dh) industri e rëndë;
- e) industri e lehtë dhe agropërpunuese;
- ë) përpunim dhe magazinim mallrash;
- f) tregtare dhe eksport-import;
- g) shërbime;
- gj) industri të tjera, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4. Periudha e funksionimit të zonës është 35 (tridhjetë e pesë) vjet, me të drejtë përsëritjeje deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet.

5. Ministria përgjegjëse për ekonominë vë në dispozicion, në funksion të zhvillimit të projektit, pasuritë e paluajtshme të llojit “arë”, të ndodhura në zonën kadastrale 3852, në Xhafzotaj, Durrës, me numra pasurie 345/55 (sipërfaqe totale 293 m²), 345/60 (sipërfaqe totale 367 m²) dhe 345/62 (sipërfaqe totale 760 m²), pjesë të zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, me sipërfaqe totale 1 420 (një mijë e katërqind e njëzet m²), sipas legjislacionit në fuqi.



6. Zhvillues i “Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” shpallet shoqëria “VERTIGO” sh.p.k.


7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË
“VERTIGO FREE ZONE–DURRËS INDUSTRIAL PARK” SHIJAK

ZK	Numri i pasurisë	Sipërfaqja totale e pasurisë (m ²)	Sipërfaqja totale ndërtësë (m ²)	Pronësia
3852	346/9	2400	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/10	2400	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/11	750	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/12	2400	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/13	2400	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/14	6720	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/18	2016	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/19	3072	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/20	3072	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/21	2016	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/22	4800	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/23	4488	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/24	3816	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/25	5904	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/26	4944	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/27	6960	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/56	4736	4478	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	346/61	12640	2671.8	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	347/17	7828	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	347/18	5856	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	347/19	6333	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	345/54	7883	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	345/55	293	0	Shteti
3852	345/58	3406.5	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	345/59	3406.5	0	“VERTIGO” sh.p.k.
3852	345/60	367	0	Shteti
3852	345/61	11810	0	“VERTIGO” sh.p.k. (kontratë enfiteoze)
3852	345/62	760	0	Shteti
3852	345/63	11738	0	“VERTIGO” sh.p.k. (kontratë enfiteoze)
		135,215	7,149.8	





URDHËR
Nr. 288, datë 6.5.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 7.5.2025–12.5.2025, zëvendësministrit të Drejtësisë, z.Klajd Karameta.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z.Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

URDHËR
Nr. 405, datë 25.4.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 21, DATË 19.1.2023, “PËR NJË PLAN MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR PESHKIMIN FUNDOR TË QËNDRUESHËM NË DETIN ADRIATIK (NËNZONAT GJEORAFIKE 17 DHE 18)”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 3, të Marrëveshjes “Për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun”, të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003,

URDHËROJ:

Në urdhrin e ministrit nr. 21, datë 19.1.2023, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin fundor të qëndrueshëm në detin Adriatik

(nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”, bëhen ndryshimet si vijon:

1. Pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Të gjitha anijet e peshkimit fundor, që peshkojnë peshq fundorë, nuk kalojnë 21011 ditë peshkimi në vitin 2025, të ndara sipas segmentit të flotës, në përputhje me pikën 4 të këtij urdhri”.

2. Pika 4 riformulohet si më poshtë:

“4. Ditët e peshkimit ndahen sipas segmenteve të flotës për anijet e peshkimit fundor që përdorin rrjetë fundore me timon (OTB)”, si më poshtë:

a) segmenti ≥ 12 m dhe < 24 m: 15 488 ditë;

b) segmenti ≥ 24 m: 5 523 ditë”.

3. Kudo në urdhër togfjalëshi “inspektorati i peshkimit” zëvendësohet me togfjalëshin “inspektorati që mbulon fushën e peshkimit”.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe inspektorati që mbulon fushën e peshkimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 406, datë 25.4.2025

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 11, DATË 14.1.2022, “PËR NJË PLAN MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR NJË SHFRYTËZIM TË QËNDRUESHËM TË REZERVAVE TË PELAGJIKËVE TË VEGJËL NË DETIN ADRIATIK (NËNZONAT GJEORAFIKE 17 DHE 18) [REKOMANDIMI I GFCM/44/2021/20]”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 3, të Marrëveshjes “Për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun”, të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003,

URDHËROJ:

Në urdhrin e ministrit nr. 11, datë 14.1.2022, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për një



shfrytëzim të qëndrueshëm të rezervave të pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18) [rekomandimi i GFCM/44/2021/20]”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Zbatimin e rekomandimit GFCM/44/2021/20 të Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për një shfrytëzim të qëndrueshëm të pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”, Rekomandimi GFCM/46/2023/5, “Për zgjatjen e regjimit tranzitor të peshkimit dhe vendosja e një limiti zëniesh për vitin 2024, për pelagjikët e vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”, bazuar nga rekomandimi GFCM/44/2021/20 dhe rekomandimi GFCM/47/2024/4 “Mbi një regjim afatgjatë dhe vendosjes së një limiti zëniesh për vitin 2025 për pelagjikët e vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”, bazuar nga rekomandimi GFCM/44/2021/20, që i bashkëlidhen këtij urdhri dhe janë pjesë përbërëse e tij”.

2. Pas pikës 4, shtohet pika 4/1 me përmbajtje si më poshtë:

“4/1. Limiti i zëniesh të pelagjikëve të vegjël të ndara sipas specieve për vitin 2025, është si më poshtë:

- a) açuge: 737 tonë;
- b) sardele: 826 tonë”.

3. Pika 5 riformulohet si më poshtë:

“5. Ky plan menaxhimi është i zbatueshëm deri më 31 dhjetor 2029”.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe inspektorati që mbulon fushën e peshkimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

REKOMANDIMI GFCM/47/2024/4 “MBI
NJË REGJIMI AFATGJATË DHE
VENDOSJES SE NJË LIMITI ZËNIESH PËR
VITIN 2025 PËR PELAGJIKËT E VEGJËL
NË DETIN ADRIATIK (NËNZONAT
GJEOGRAFIKE 17 DHE 18)”,
BAZUAR NGA REKOMANDIMI
GFCM/44/2021/20

Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (KPPM/GFCM),

duke konsideruar se qëllimi i Marrëveshjes për themelimin e Komisionit të Përgjithshëm për Peshkimin në Mesdhe (Marrëveshja e GFCM-së) është të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm, në nivel biologjik, social, ekonomik dhe mjedisor, të burimeve të gjalla detare në zonën e zbatimit të GFCM-së;

duke rikujtuar se, në zbatim të qëllimit të Marrëveshjes së GFCM-së, GFCM-ja do të miratojë rekomandime për masa ruajtjeje dhe menaxhimi me synimin për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të aktiviteteve të peshkimit, me qëllim ruajtjen e burimeve të gjalla detare dhe qëndrueshmërinë ekonomike e sociale të sektorit të peshkimit dhe se, gjatë miratimit të këtyre rekomandimeve, GFCM-ja do t'i kushtojë vëmendje të veçantë masave për të parandaluar mbipeshkimin dhe për të minimizuar hedhjet e peshkut, si dhe ndikimeve të mundshme në peshkimin në shkallë të vogël dhe komunitetet lokale;

duke konsideruar këshillën shkencore më të fundit, të miratuar nga Komiteti Këshillimor Shkencor për Peshkimin (SAC) në sesionin e tij të njëzet e pestë (Francë, 2024), e cila tregon për një mbipeshkim të vazhdueshëm të rezervës së sardeles dhe një përmirësim të gjendjes së rezervës së açuges në detin Adriatik;

duke konsideruar se SAC, në sesionin e tij të njëzet e pestë, njohu përmirësimin e vërejtur në biomasa e açuges ndërmjet vlerësimeve të mëparshme dhe vlerësimit aktual dhe se ajo tashmë ishte mbi nivelin B_{PA} , duke theksuar se ulja e vërejtur e vdekshmërisë nga peshkimi e solli atë në nivelin FMSY, ndërsa për sardelen vërejtji se biomasa ishte ulur më tej pavarësisht një reduktimi të zëniesh, megjithatë mbetej ende mbi nivelin B_{PA} ;

duke konsideruar se vlerësimi referues për sardelen u përfundua në vitin 2023 dhe se grupi i punës për vlerësimin e Strategjisë së Menaxhimit (WGMSE)



përfundoi vlerësimin e Strategjisë së Menaxhimit (MSE) për rregullat e propozuara të kontrollit të zënieve (HCRs), në përputhje me paragrafët 16–18, të rekomandimit GFCM/44/2021/20 mbi një plan shumëvjeçar menaxhimi për shfrytëzimin e qëndrueshëm të rezervave të pelagjikeve të vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18);

duke rikujtuar se SAC, në sesionin e tij të njëzet e pestë, vlerësoi punën e kryer nga WGMSE në kuadër të procesit të vlerësimit të Strategjisë së Menaxhimit (MSE) për pelagjikët e vegjël në detin Adriatik, duke vënë në dukje se procesi i MSE kishte marrë parasysh një numër të madh skenarësh menaxhimi, përmes një procesi me dy hapa që kishte parashikuar një sërë simulimesh bazë dhe testesh të detajuara të qëndrueshmërisë, duke ofruar udhëzime të mira mbi rregullat e mundshme të kontrollit të zënieve (HCRs) që mund të zbatohen në peshkimin e pelagjikeve të vegjël;

duke rikujtuar se SAC njohu përpjekjet e bëra nga ekspertët e WGMSE për të marrë parasysh një gamë të gjerë pasigurish dhe inputesh të theksuara nga palë të ndryshme të interesuara, duke mundësuar një analizë të performancës së rregullave të kontrollit të zënieve (HCRs) në lidhje me qëndrueshmërinë e zënieve, ndërkohë që WGMSE zhvilloi njëkohësisht teste të qëndrueshmërisë/stresit që morën parasysh si mungesat e mundshme në rekrutimin e rezervave të shkaktuara nga faktorë mjedisorë apo ndryshimet klimatike, ashtu edhe ndryshimet e mundshme në vdekshmërinë natyrore të shkaktuara nga rritja e grabiqarizmit, p.sh. nga ton i kuq (*Thunnus thynnus*);

duke konsideruar se SAC, në sesionin e tij të njëzet e pestë, shqyrtoi masat e menaxhimit që do të zbatohen në fazën afatgjatë të planit shumëvjeçar, duke vënë në dukje se masat në hapësirë dhe në kohë kishin rezultuar efektive dhe duke rekomanduar që ato të mbahen edhe gjatë periudhës së ardhshme;

miraton, në përputhje me dispozitat e neneve 5, shkronja “b”, 8, shkronja “b” dhe 13 të Marrëveshjes së GFCM-së, rekomandimin e mëposhtëm:

1. Në përputhje me paragrafët 17 dhe 18, të rekomandimit GFCM/44/2021/20, plani afatgjatë i menaxhimit do të fillojë më 1 janar 2025 dhe do të përfundojë më 31 dhjetor 2029. Në përputhje me këtë, paragrafi 55 i atij rekomandimi do të

ndryshohet për të pasqyruar se kohëzgjatja e planit është tetë vjet.

2. Rregullat e Kontrollit të Zënieve (HCRs), në përputhje me kërkesat e paragrafit 18, të rekomandimit GFCM/44/2021/20 dhe të miratuara nga SAC, për menaxhimin e sardeles dhe açuges në detin Adriatik janë:

a) për sardelen, rregulla e kontrollit të zënieve (HCR) është e parametruar me Btr1 në Blim, Btr2 në B_{PA} dhe Btrig3 = 1.1 BMSY, ndërsa Cmin është vendosur në 20 000 tonë dhe Cmax në 50 000 tonë; dhe

b) për açugen, rregulla e kontrollit të zënieve (HCR) është e parametruar me Btr1 në Blim (16 200 tonë), Btr2 në B_{PA} (21 400 tonë) dhe Btr3 në 46 400 tonë, ndërsa Cmin është vendosur në 15 000 tonë dhe Cmax në 35 000 tonë.

3. Rregullat e Kontrollit të Zënieve (HCRs) në paragrafin 2 të këtij rekomandimi do të shërbejnë si bazë për përcaktimin e kufijve vjetorë të zënieve për secilën specie.

4. Në përputhje me paragrafin 17 të rekomandimit GFCM/44/2021/20, mbi bazën e zbatimit të rregullave të kontrollit të zënieve (HCRs) të përmendura në paragrafin 2 dhe të keshillës së SAC, GFCM-ja do të miratojë kufij të veçantë zëniesh, sipas palës kontraktuese dhe palës bashkëpunuese jokontraktuese, për sardelen dhe açuges për vitin 2025. Në bazë të këtij paragrafi, kufijtë e zënieve për vitin 2025 janë përcaktuar në aneksin e këtij rekomandimi.

5. Kufizimet në hapësirë dhe në kohë të përmendura në paragrafët 23–26 (pjesa IV, “Mbi masat teknike”) të rekomandimit GFCM/44/2021/20 do të zgjaten për një vit. SAC, në sesionin e tij të njëzet e gjashtë në vitin 2025, do të vlerësojë masat e përmendura në paragrafët 21 dhe 23–26 të rekomandimit GFCM/44/2021/20 dhe në paragrafin 3 të rekomandimit GFCM/38/2014/1 mbi masat paraprake dhe emergjente për vitin 2015 për rezervat e pelagjikeve të vegjël në nënzonën gjeografike 1, duke ndryshuar rekomandimin GFCM/37/2013/1, dhe do të japë këshilla mbi masa alternative dhe/ose shtesë ndaj atyre të përfshira në këtë paragraf, si dhe për një mekanizëm të mundshëm të menaxhimit të kuotave që do të zbatohet nga viti 2026.



SHTOJCA 1

Tabela e mundësive të peshkimit për vitin 2025, sipas palëve kontraktuese për sardelen dhe açugen në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17–18)

Speciet	Bashkimi Evropian 2025 (ton)	Shqipëria 2025 (ton)	Mali i Zi 2025 (ton)
Açuge	26 453	737	176
Sardele	45 419	826	270

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË ÇËSHTJA FORTUZI KUNDËR SHQIPËRISË (kërkesa nr. 29237/18)

VENDIM

STRASBURG
22 prill 2025

Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Fortuzi kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komiteti i përbërë nga:

Lətif Hüseyinov, kryetar,

Darian Pavli,

Úna Ní Raifeartaigh, gjyqtarë,

dhe Olga Chernishova, Zëvendëskancelare e Seksionit,

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 29237/18) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), më 12 qershor 2018, nga shtetasi shqiptar z. Gazmend Fortuzi (kërkuesi), i lindur në vitin 1937, me banim në Tiranë dhe i përfaqësuar nga znj. S. Mëneri, avokate e licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar qeverinë e Shqipërisë (Qeveria) të përfaqësuar nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, për ankimet në lidhje me kohëzgjatjen e procesit për të drejtat e pronësisë së kërkuesit dhe të drejtën e kërkuesit për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese, dhe vendimin për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 18 mars 2025,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë me procesin administrativ dhe një padi civile me anë të të cilës kërkuesi kundërshtoi një vendim administrativ që rrëzoi pretendimin e tij për kthimin e pronës. Kërkuesi u ankua për kohëzgjatjen e këtyre proceseve gjyqësore dhe për mungesën e të drejtës së tij për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

2. Në vitin 1995, kërkuesi depozitoi një kërkesë në Zyrën Rajonale të Durrësit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (këtu e më poshtë Zyra e Durrësit), ku kërkoi kthimin e një prone që babai i tij i kishte shitur palëve të treta. Kërkesa e kërkuesit u refuzua më 28 qershor 2007 dhe në korrik 2007 kërkuesi depozitoi një ankim në Agjencinë e Tiranës për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (këtu e më poshtë “Agjencia e Tiranës”). Më 13 shtator 2007, Agjencia e Tiranës e refuzoi edhe këtë kërkesë të kërkuesit.

3. Më 10 maj 2010, kërkuesi paraqiti padi civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku kërkoi anulimin e vendimeve administrative të lartpërmendura dhe njohjen e pronësisë së tij mbi pronën në fjalë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë rrëzoi ankimin e kërkuesit më 21 tetor 2011.

4. Më 4 nëntor 2011, kërkuesi depozitoi një ankim kundër vendimit të shkallës së parë. Në proceset përpara Gjykatës së Apelit Tiranë kërkuesi kërkoi shtyrjen e seancave të 17 majit, 7 dhe 20 qershorit dhe 17 korrikut 2021 për shkak të mungesës së avokatit. Më 20 nëntor 2012, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e kontestuar.

5. Më 20 shtator 2014, kërkuesi paraqiti një rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila e rrëzoi atë përfundimisht më 8 dhjetor 2015. Kërkuesi nuk u njoftua për vendimin e Gjykatës së Lartë.

6. Më 8 nëntor 2016, në Fletoren Zyrtare u publikua ligji nr. 99/2016. i 6 nëntorit 2016. Ligji



shkurtoi afatin kohor për depozitimin e një ankimi kushtetues nga dy vjet në katër muaj “nga momenti i marrjes dijeni për ndërhyrjen” [në një të drejtë ose liri kushtetuese]” (*konstatimi i cenimit*). Ai parashikoi edhe që afati i ri kohor duhet të hyjë në fuqi më 1 mars 2017.

7. Kërkuesi mësoi për vendimin e Gjykatës së Lartë më 22 qershor 2017, kur mori vendimin nga Zyra e Regjistrimit të Gjykatës së Rrethit.

8. Më 21 tetor 2017, kërkuesi depozitoi një ankim kushtetues. Ai u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese, më 7 dhjetor 2017, si i depozituar jashtë afatit kohor katërmujor, duke filluar nga data e miratimit të vendimit të kontestuar të Gjykatës së Lartë.

9. Qeveria pretendoi se kërkuesi kishte marrë vendimin e Gjykatës Kushtetuese më 7 dhjetor 2017. Kërkuesi pretendoi që e kishte marrë më 12 dhjetor 2017 dhe paraqiti një njoftim të Gjykatës Kushtetuese që vendimi i 7 dhjetorit 2017 kërkuesit i ishte dërguar më 12 dhjetor 2017.

10. Më 28 mars 2023, kërkuesi ndërroi jetë dhe bashkëshortja e tij Ildika Fortuzi dhe fëmijët e tij Gledion Fortuzi, Eldira Fortuzi dhe Adhurin Fortuzi shprehën dëshirën për të ndjekur kërkesën.

VLERËSIMI I GJYKATËS

SHKELJET E PRETENDUARA TË NENIT

6 § 1 TË KONVENTËS

A. Pranueshmëria

11. Gjykata vëren që ankimet për kohëzgjatjen e procesit dhe për të drejtën e kërkuesit për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese nuk janë haptazi të pabazuara, sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës ose të papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Prandaj, ato duhet të shpallen të pranueshme.

B. Themeli

1. Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore

12. Parimet e përgjithshme në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor janë përmbledhur në çështjen *Frydlender kundër Francës* ([DHM], nr. 30979/96, § 43, GJEDNJ 2000-VII).

13. Procesi gjyqësor në fjalë filloi në vitin 1995. Megjithatë, për qëllimet e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor periudha që duhet të merret parasysh filloi në korrik 2007, kur kërkuesi depozitoi një ankim kundër vendimit të Agjencisë që rrëzoi kërkesën e tij dhe kur lindi një “mosmarrëveshje” sipas kuptimit të paragrafit 1, të nenit 6 (shihni, për shembull *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 dhe 17766/19, § 64, 12 tetor 2021, dhe *Mitkova kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 48386/09, §

49, 15 tetor 2015). Proceset përpara autoriteteve administrative përfunduan me vendimin e Agjencisë së Tiranës, të 13 shtatorit 2007, pra zgjatën rreth tre muaj që nuk mund të konsiderohet si kohëzgjatje e tepruar.

14. Më 10 maj 2010, kërkuesi filloi procesin gjyqësor për të kërkuar shfuqizimin e vendimeve administrative në fjalë. Këto procese përfunduan me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, të 12 dhjetorit 2017. Prandaj ato zgjatën rreth shtatë vjet dhe shtatë muaj përpara të katër shkallëve të juridiksionit.

15. Gjykata vërejtë që çështja kishte të bënte me një mosmarrëveshje për të drejtat e pronësisë së kërkuesit. Edhe pse këto procese nuk kishin natyrë emergjente, ato gjithsesi e mbajtën kërkuesin në gjendje pasigurie për pronën në fjalë për një periudhë kohore të gjatë.

16. Gjykata vëren që kërkuesi kontribuoi në një farë mase në kohëzgjatjen e procesit, duke kërkuar shtyrjen e seancave gjyqësore përpara Gjykatës së Apelit Tiranë në maj, qershor dhe korrik 2012 (shihni paragrafin 4 më lart).

17. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve të brendshme, Gjykata vëren që Gjykata e Apelit Tiranë miratoi vendimin e saj më 20 nëntor 2012. Megjithatë, duket se kërkuesi nuk është njoftuar për atë deri në gusht 2014 sepse rekursi i tij më tej në Gjykatën e Lartë, i depozituar më 20 shtator 2014, nuk u shpall i papranueshëm për depozitim jashtë afatit dhe afati kohor për depozitimin e një rekursi në Gjykatën e Lartë për çështjet civile ishte tridhjetë ditë nga data që një palë kishte marrë vendimin e kontestuar (neni 443 i Kodit të Procedurës Civile).

18. Po kështu, vendimi i Gjykatës së Lartë, i miratuar më 8 dhjetor 2015, nuk ju njoftua kërkuesit dhe ai u njoftua për atë vendim vetëm më 22 qershor 2017.

19. Nisur nga kohëzgjatja e përgjithshme e proceseve gjyqësore dhe vonesat në njoftimin e kërkuesit për vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe faktin që vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i ishte njoftuar, Gjykata vlerëson që ka pasur shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës për shkak të kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore në fjalë.

2. Aksesit në Gjykatën Kushtetuese

20. Parimet e përgjithshme, në lidhje me të drejtën për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, në lidhje me afatin e ri katërmujor të prezantuar rishtazi për depozitimin e një ankimi kushtetues janë përmbledhur në *Supergrav Albania*



sh.p.k. kundër Shqipërisë (nr. 20702/18, §§ 16 dhe 22, 9 maj 2023). Në atë çështje Gjykata gjeti shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës ku afati kohor për depozitimin e një ankimi kushtetues ishte llogaritur nga data e miratimit të vendimit të kontestuar të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data e njoftimit të tij tek kërkuesi (ibid., §§ 17–31).

21. Në këtë çështje kërkuesi mësoi për vendimin e Gjykatës së Lartë më 22 qershor 2017 dhe depozitoi ankimin e tij kushtetues më 21 tetor 2017, brenda afatit kohor katërmujor.

22. Gjykata Kushtetuese u shpreh që vula në vendimin e Gjykatës së Lartë, që mban datën 22 qershor 2017, nuk mund të konsiderohej si provë që ai vendim i ishte njoftuar kërkuesit po në atë datë sepse sa herë që një palë kërkonte të merrte vendimin e Gjykatës së Lartë, në atë vendim vendosej vula me datën e njoftimit. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nuk sqaroi në çfarë mënyre një palë mund të jepte një provë pozitive të datës së njoftimit të parë (krahasoni *Aždajić kundër Sllovenisë*, nr. 71872/12, § 69, 8 tetor 2015) ose arsyen pse barrën e provës në këtë drejtim duhej ta kishte vetëm njëra palë. Gjykata vlerëson se fillimisht i takon Gjykatës së Lartë të sigurohet që në dosjen e saj të çështjes të ketë prova për datën e njoftimit të vendimit të saj te palët (shihni *mutatis mutandis*, *Zela kundër Shqipërisë*, nr. 33164/11, § 38, 11 qershor 2024).

23. Nisur nga rrethanat më sipër, Gjykata del në përfundimin që gjen shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës, në lidhje me të drejtën e kërkuesit për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

24. Kërkuesi nuk paraqiti një pretendim specifik për shpërblim të drejtë. Prandaj, Gjykata vlerëson se nuk ka arsye që atij t’i jepet ndonjë shumë për këtë qëllim.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. *shpall* kërkesën të pranueshme;

2. *shprehet* që është shkelur paragrafi 1, i nenit 6 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore civile në fjalë dhe të drejtën e kërkuesit për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 22 prill 2025 sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

ZËVENDËSKANCELARE
Olga Chernishova

KRYETAR
Latif Hüseyinov

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 18948/22

**Bukuriye PETRELA dhe të tjerët kundër
Shqipërisë dhe 4 kërkesa të tjera**
(shihni tabelën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 18 mars 2025, si Komitet i përbërë nga:

Latif Hüseyinov, *kryetar*,

Darian Pavli,

Úna Ní Raifeartaigh, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit*,

duke pasur parasysh:

kërkesat (nr. 18948/22, 20351/22, 20354/22, 21643/22, dhe 22197/22) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituara në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) nga kërkuesit e listuar në tabelën bashkëlidhur (“kërkuesit”), në data të ndryshme që tregohen në tabelë, të përfaqësuar në Gjykatë nga znj. S.Mëneri, avokat i licencuar në Tiranë;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJEVE

1. Kërkesat kanë të bëjnë me tejzgjatjen e mosekzekutimit të vendimeve administrative që njihnin të drejtën e kërkuesve për kompensim sipas një nga mënyrave të parashikuara me ligj *in lieu* të kthimit të pronave të tyre që ishin shtetëzuar nga ish-regjimi komunist.

2. Gjatë vitit 1995, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë (“Komisioni i Pronave”) nxori disa vendime që njihnin të drejtat e pronës së trashëguar të kërkuesve mbi disa parcela toke. Në lidhje me pjesën e parcelave që ishin të zëna, ai vendosi që kërkuesit të kompesoheshin sipas njëres prej mënyrave të parashikuara me ligj.



3. Më 8 maj 2017, vlerësimi financiar në lidhje me pronat e kërkuësve u publikua në *Buletinin e Njoftimeve Zyrtare* në përputhje me ligjin nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (“Ligji për pronat 2015”). Kërkuësit nuk kundërshtuan atë vendim përfundimtar vlerësimi. Ndërmjet periudhës maj dhe gusht 2017, ata paraqitën formularët dhe dokumentacionin e nevojshëm për kompensimin financiar bazuar në vendimin e Agjencisë për Trajtimin e Pronave (“ATP”).

4. Në vitin 2022, në përgjigje të kërkesës së kërkuësve për informacion, ATP-ja njohu vlerësimin e pronave të tyre në vitin 2017 dhe i informoi që nuk ishin ndërmarrë veprime të tjera në lidhje me kompensimin e tyre, sepse priteshin ndryshime të tjera ligjore pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese (shihni paragrafin 9 më poshtë).

5. Më 5 tetor 2023, 14 dhjetor 2023, 13 tetor 2023, 23 gusht 2023 dhe 20 janar 2022, përkatësisht, ATP-ja informoi kërkuësit që për ata do të zbatoheshin dispozitat e miratuara rishtazi (shihni paragrafin 8 më sipër), iu kërkoj që ata të tregonin për formën e preferuar të kompensimit dhe të paraqisnin dokumentet e nevojshme për të përfunduar procesin e kompensimit. Nga materialet e dosjes së çështjes nuk rezulton që kërkuësit kanë përmbushur të gjitha këto kërkesa.

LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

6. Një vështrim i përgjithshëm i legjislacionit të brendshëm dhe praktikës përkatëse sipas ligjit për Pronat 2015 jepet në çështjen *Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë* ((ven.), nr. 29026/06 dhe 11 të tjerë, §§ 29–109, 17 mars 2020). Në atë vendim, Gjykata gjeti që mjeti juridik i prezantuar me ligjin për pronat 2015 ishte efektiv sipas kuptimit të paragrafit 1 të nenit 35 dhe nenit 13 të Konventës.

7. ATP-ja brenda tre vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit duhej të kryente vlerësimin financiar të të gjitha vendimeve që njihnin të drejtën e kompensimit, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 15 të ligjit për pronat. Në të kundërt, me mbarrimin e afatit tre vjeçar, ish-pronarët do të kishin të drejtë të fillonin procesin gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë për të kërkuar vlerësimin financiar të vendimeve përfundimtare që njihnin të drejtat e pronës dhe të drejtën për kompensim, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 15 të ligjit për pronat. Sipas nenit 19 të ligjit,

vendimet e ATP-së për vlerësimin financiar mund të ankimoheshin në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 30 ditëve nga njoftimi i tyre, vetëm në lidhje me masën e kompensimit të vlerësuar.

8. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 223/2016 (shihni *Beshiri dhe të tjerët*, i përmendur më sipër) u ndryshua me vendimin nr. 766/2017, i cili hyri në fuqi më 27 dhjetor 2017. Ky ndryshim, në veçanti, vendosi një tavan për kompensimin financiar (d.m.th. monetar) në 20% të vlerës së marrë si rezultat i vlerësimit dhe 80% për kompensimin në natyrë nga Fondi i Tokave. Këto ndryshime përfshinë edhe radhën e përparësisë për llojet e mëposhtme të kompensimit: (a) kompensimi në natyrë brenda pronës së shpronësuar të ish-pronarëve; (b) kompensimi në natyrë nga Fondi i Tokave; dhe (c) kompensimi monetar. Pra, kompensimi monetar do të jepej vetëm nëse nuk mund të jepej kompensimi në natyrë dhe do të jepej në masën 20% të vlerësimit financiar të përgjithshëm (shihni *Beshiri dhe të tjerët*, përmendur më sipër §§ 90–98).

9. Pas dhënies së vendimit në çështjen *Beshiri dhe të tjerët* (përmendur më sipër) më 15 shkurt 2021, Gjykata Kushtetuese mori një vendim në përgjigje të një kërkesë për rishikim kushtetues *in abstracto* të disa dispozitave të ligjit për pronat 2015, që shfuqizoi nenin 7 (2) (a) dhe (b) dhe disa dispozita të vendimeve zbatuese. Në çështjen *Ruçi dhe Bejleri kundër Shqipërisë* (ven.), Gjykata vlerësoi që gjetjet e Gjykatës Kushtetuese nuk justifikonin shmangien nga gjetjet e saj që kompensimi përsëri mbetej një mjet efektiv, sipas kuptimit të paragrafit 1 të nenit 35 dhe nenit 13 të Konventës ([Komiteti], nr. 56937/10 dhe 191 të tjerë, § 22, prill 2021).

VLERËSIMI I GJYKATËS

10. Duke pasur parasysh objektin e ngjashëm të kërkesave, Gjykata e sheh të përshtatshme t'i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

11. Kërkuësit u ankuan për shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 dhe nenit 13 të Konventës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, për shkak të mosekzekutimit nga autoritetet të vendimeve përfundimtare që përcaktonin të drejtën e tyre për të marrë kompensimin *in lieu* të kthimit të pronave, bazuar në vendimet për vlerësimin financiar që ata konsideronin të formës së prerë në vitin 2017.

12. Kërkuësit pretenduan që dispozitat e prezantuara rishtazi nuk zbatoheshin për ata dhe që kompensimi monetar nuk kishte tavanin 20% të



vlerësimit financiar të përgjithshëm (shihni paragrafin 8 më lart) kur ata bënë kërkesën për kompensim.

13. Në çështjen e lart-përmendur, *Beshiri dhe të tjerët*, Gjykata u shpreh që ligji për pronat 2015 ishte hartuar për të trajtuar çështjen e ekzekutimit të të drejtave të ish-pronarëve për kompensim në mënyrë efektive dhe domethënëse, duke pasur parasysh kërkesat e Konventës (përmendur më lart, §§ 215 dhe 217). Në atë vendim, Gjykata u shpreh që nuk kishte për detyrë “të përcaktonte hierarkinë e formave të kompensimit që duhej të jepej nga autoritetet e brendshme”, dhe që kuadri ligjor i brendshëm “duhet të përshkruajë dhe të përcaktojë me qartësi të mjaftueshme ushtrimin e diskrecionit nga ATP - ose autoritetet tjetër zbatues - në vendimmarrje për dhënien e kompensimit” (ibid. §§ 179 dhe 180).

14. Gjykata përsërit që vendimet administrative për pronat janë “përfundimtare” për qëllimet e paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës, sa kohë që ato nuk kundërshtohen dhe “gjenerojnë të drejta që janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme” (shihni për shembull, *Ramadhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 38222/02, § 36, 13 nëntor 2007; *Hamzëraj kundër Shqipërisë (nr. 1)*, nr. 45264/04, § 26, 3 shkurt 2009; dhe *Nuri kundër Shqipërisë*, nr. 12306/04, § 28, 3 shkurt 2009).

15. Në lidhje me çështjet në fjalë, Gjykata vëren që vlerësimet financiare të pronave të kërkuësve të cilat nuk mund të ktheheshin u publikuan në maj 2017 (shihni paragrafin 3 më lart). Linja kryesore e arsyetimit të kërkuësve është që ndryshimet e prezantuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 766/2017, legjislacion dytësor, nuk duhej të zbatoheshin në mënyrë “prapavepruese” për çështjet e tyre, të cilat ishin vendosur në rrugë administrative nga Agjencia përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve. Kështu kërkuësit ftojnë Gjykatën të zgjidhë mosmarrëveshjen në lidhje me interpretimin e së drejtës kombëtare, pa ndërmarrë ndonjë veprim të çfarëdo lloji për të kundërshtuar interpretimin e Agjencisë përpara gjykatave kombëtare. Gjykata rikujton që vendimet e Agjencisë në lidhje me masën e kompensimit, në parim, janë objekt ankimi përpara Gjykatës Administrative të Apelit (shihni paragrafin 7 më lart), që përbën një mjet juridik, i cili duhet të shterohet. Në masën që kërkuësit pretendojnë se sipas së drejtës kombëtare nuk ekziston asnjë

zgjidhje efektive “e zakonshme” në rrethanat e çështjes së tyre, kërkuësit nuk e kanë ngritur atë pretendim të paktën përpara Gjykatës Kushtetuese, që kërkohej në parim të vlerësojë nëse i tillë është rasti dhe të japë ndonjë zgjidhje të duhur për pretendimet e tyre sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1.

16. Gjykata vëren që ATP-ja ka informuar kërkuësit që për kompensimin e tyre nuk është marrë asnjë vendim përfundimtar sepse nevojiteshin ndryshime të tjera ligjore dhe rregullatore për të respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese (shihni paragrafin 4 më lart). Sipas regjimit ligjor përkatës që ka rezultuar nga këto ndryshime (shihni paragrafin 8 më lart), vlera e përlogaritur mund të jepej si kompensim në natyrë, kompensim financiar, ose kombinim i të dyjave. Sidoqoftë, çdo mosmarrëveshje për këtë çështje do t'i nënshtrohej, në parim, ankimit përpara Gjykatës Administrative të Apelit.

17. Më tej, pas vlerësimeve të Agjencisë, kërkuësit nuk kanë ndërmarrë veprime efektive për të siguruar zbatimin e vendimeve të kompensimit. Në veçanti, ata nuk kanë përmbushur kërkesat e ATP-së për të dhënë dokumentet e nevojshme dhe për të treguar zgjedhjen e tyre për format e kompensimit (shihni paragrafin 5 më lart). Kështu Gjykata vëren që kërkuësit ose nuk kanë përmbushur këto kërkesa ose nuk kanë informuar Gjykatën për ndonjë veprim për t'i kundërshtuar ato. Duke pasur parasysh specifikat e legjislacionit për kthimin e pronave, fakti që kërkuësve u kërkohej pjesëmarrje aktive nuk mund të konsiderohet si vendosja e një barre të tepruar ose të paarsyeshme mbi ata.

18. Në përfundim, aktualisht nuk duket se ka ndonjë vendim administrativ përfundimtar nga ATP-ja për modalitetet dhe llojin e kompensimit që duhet t'i jepet kërkuësve. Prandaj kërkuësve u kërkohej që të përdorin zgjidhjet e brendshme në lidhje me llojet e kompensimit që u jepet atyre, ose në lidhje me mosmarrjen e këtyre vendimeve nga ATP-ja.

19. Gjykata shprehet që autoritetet e brendshme, të cilat janë në pozitën më të mirë për të vlerësuar aspektet praktike, përparësitë dhe interesat konkurruese në nivel të brendshëm, gëzojnë një diskrecion të gjerë për zgjedhjen e formave të korrigjimit për shkeljen e të drejtës së pronës (shihni *Beshiri dhe të tjerët*, përmendur më sipër, § 188). Gjykata nuk sheh arsye për t'u shmangur nga ky



konkluzion në lidhje me përcaktimin e llojit dhe modaliteteve të kompensimit të duhur.

20. Në përfundim, Gjykata rikujton që ndryshimet e shpeshta në skemën e kompensimit kombëtar në kontekstin e kthimit të pronave synojnë të cenojnë parimin e sigurisë juridike dhe duhet të shmangen. Në këtë drejtim, mund të lindin pyetje, në parim, për justifikimin për ndryshimet e konsiderueshme të prezantuara me vendimin nr. 766/2017, pak më shumë se një vit pas miratimit të rregullave zbatueshme të ligjit për pronat 2015 përmes vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223/2016 (shihni *Beshiri dhe të tjerët*, përmendur më sipër, § 201). Sido që të jetë, Gjykata nuk mund të trajtojë këto pyetje në çështjet në fjalë, kur vetë zbatueshmëria e ndryshimeve të vitit 2017 për çështjet e kërkuarve mbetet akoma për t'u testuar në nivel kombëtar dhe kur autoritetet kombëtare nuk kanë miratuar vendime kompensimi përfundimtare.

21. Për rrjedhojë, ankimet e kërkuarve sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës dhe nenit 1 të

Protokollit nr. 1 duhet të refuzohen sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshkrimin e mjeteve të brendshme ligjore.

22. Gjykata nuk sheh arsye për t'u shmangur nga gjetjet për aksesueshmërinë dhe efikasitetin e zgjidhjes të parashikuar nga ligji për pronat 2015 (shihni *Beshiri dhe të tjerët*, përmendur më sipër, § 221, dhe *Ruçi dhe Bejleri*, përmendur më sipër, § 26). Ankimi i kërkuarve sipas nenit 13 të Konventës është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

vendos të bashkojë kërkesat;

shpall kërkesat të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim, më 24 prill 2025.

ZËVENDËSKANCELARE
E SEKSIONIT
Olga Chernishova

KRYETAR
Lutif Hüseyinov

SHTOJCË

Lista e çështjeve:

Nr.	Kërkesa nr.	Emri i çështjes	Depozituar më	Kërkuar Viti i lindjes Vendi i qëndrimit Shtetësia	Përfaqësuar nga
1.	18948/22	Petrela dhe të tjerët kundër Shqipërisë	8.4.2022	Bukurije PETRELA 1937 Tiranë Shqiptare Klitor PETRELA 1976 Tiranë Shqiptar Mirjan PETRELA 1942 Tiranë Shqiptar Natasha PETRELA 1953 Tiranë Shqiptare Sokol PETRELA 1971 Maria Enzesdorf Shqiptar	Suela Mëneri



Nr.	Kërkesa nr.	Emri i çështjes	Depozituar më	Kërkues Viti i lindjes Vendi i qëndrimit Shtetësia	Përfaqësuar nga
2.	20351/22	Shllaku kundër Shqipërisë	16.4.2022	Nine SHLLAKU 1937 Tiranë Shqiptare	Suela Mëneri
3.	20354/22	Kacerja dhe të tjerët kundër Shqipërisë	16.4.2022	Ardiana KACERJA 1961 Tiranë Shqiptare Mimoza HADO 1957 Tiranë Shqiptare Manjola XHIKU 1961 Tiranë Shqiptare	Suela Mëneri
4.	21643/22	Bardhoshi dhe Papinova kundër Shqipërisë	25.4.2022	Lirije BARDHOSHI 1945 TIRANË Shqiptare Genti BARDHOSHI 1969 Tiranë Shqiptar Sonila PAPINOVA 1974 Tiranë Shqiptare	Suela Mëneri
5.	22197/22	Xhuglini kundër Shqipërisë	23.4.2022	Fitnet XHUGLINI 1935 Tiranë Shqiptar Bulent XHUGLINI 1973 Tiranë Shqiptar Dhurata XHUGLINI 1945 Tiranë Shqiptare Marlind XHUGLINI 1980 Tiranë	Suela Mëneri



Nr.	Kërkesa nr.	Emri i çështjes	Depozituar më	Kërkues Viti i lindjes Vendi i qëndrimit Shtetësia	Përfaqësuar nga
				Shqiptar Meliz XHUGLINI 1968 Tiranë Shqiptar	

KËRKESË

Shtetasi Marsel Goxhaj kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier shpalljen të zhdukur të shtetasit Nazmi Goxhaj, i datëlindjes 19.2.1963.

KËRKUES
Marsel Goxhaj

KËRKESË

Shtetasja Erida Nure, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, shpalljen të zhdukur të shtetasit Muhamet Nure, me atësi Saqush dhe amësi Ildo, lindur më 7.9.1948, në Zhupan Fier, dhe caktimin si kujdestar ligjor për administrimin e pasurisë së tij të bijën, Erida Nure.

KËRKUESE
Erida Nure

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë

